

VLERA E



NUK MATET

PJESËMARRJA NË DEMOKRACI


SHPAT (11), ERIONA (11), ELDON (11), VIOL (10), ELIZA (11)

A e keni pyetur ndonjëherë veten se si munden qytetarët e Kosovës ta forcojnë demokracinë e vendit tonë? Nëse dëshironi të dini më shumë për këtë temë, atëherë lexojeni artikullin tonë

Të gjithë qytetarët e Kosovës duhet të jenë të regjistruar në regjistrin civil si dhe duhet të kenë leje qëndrim të vlefshëm, që të jenë qytetar të një shteti. Nëse ne, bashkë me shokët tanë, shkojmë në Afrikë, Gjermani ose në ndonjë vend tjetër, ne nuk jemi qytetarë të atij vendi por jemi vetëm turistë. Mirëpo, edhe nëse vie ndonjë afrikan apo gjerman, edhe ata janë vetëm turistë në Kosovën tonë. Kosova edhe pse është shumë e vogël, ajo ka banorë të etnive të ndryshme. Si komunitete jo shumicë ne kemi komunitetin serb, romë, ashkali, turk, boshnjak, egjiptian. Edhe shqiptarët e Kosovës bashkë me këto komunitete duhet të jenë qytetarë sa më aktiv në vendin tonë. Kjo sepse demokracia jonë ka nevojë për të gjithë neve.

Por, si mund të jemi qytetarë aktiv? Ne duhet të punojmë për vendin tonë, ne duhet të votojmë në zgjedhjet demokratike, ne duhet të nënshkruajmë peticione për çështje të ndryshme siç është asfaltimi i rrugëve, dhe ne duhet të marrim pjesë në tubime publike. Në ato tubime publike ne do të diskutonim për të rregulluar një park në qytetin tonë dhe aty duhet të mbledhim të gjithë qytetarët. Për t'i bërë të gjitha këto duhet t'i kemi mbi 18 vjet.

Edhe fëmijët, të cilët nuk kanë mbushur akoma moshën 18 vjeçare mund të bëjnë shumë gjëra për demokracinë. Ata duhet të mësojnë në shkollë, të bëjnë detyrat e shtëpisë, të kujdesen për njëri-tjetrin, dhe të respektojnë rregullat e shkollës.




Ne kemi të drejtë të kemi ambient të pastër



Ja se si duken gazetarët gjatë punës



Ne jemi gazetarët që kemi shkruar këtë artikull



Qytetarët kanë shumë të drejta dhe përgjegjësi

Në këtë pjesë të artikullit, do të mund të lexoni për të drejtat dhe përgjegjësitë tona si qytetarë të Kosovës, por edhe si fëmijë


Të drejtat e barabarta të qytetarëve janë liri të cilat i gëzojmë në demokraci. Në shtetin tonë disa nga këto të drejta janë: e drejta për t'u shkolluar, e drejta për të mësuar, e drejta për të punuar, e drejta për të zgjedhur profesionin i cili na pëlqen më shumë, etj. Ne po ashtu kemi të drejtën për të votuar mbi moshën 18 vjeçare. Kur ne kemi të drejta, ne kemi edhe përgjegjësi. Ato janë: të mësojmë, të bëjmë detyrat e shtëpisë, të respektojmë të moshuarit, të respektojmë shokët dhe shoqet, ta mbajmë ambientin e pastërt, të mbledhim mbeturinat, të ndihmojmë dikë që ka nevojë, të ndihmojmë prindërit, etj. Nëse nuk do të kishim obligime dhe detyra atëherë ne nuk do të kishim paqe, nuk do të rrinim së bashku dhe shteti ynë do të shkatërrohej. Prandaj, ne ju lusim të respektoni të gjithë që së bashku të forcojmë demokracinë.



Regjistri Civil i Kosovës




Kuvendi ndryshe njihet si „Shtëpia e Popullit“



Voto për demokracinë



Kjo është mosha prej të cilës ne fillojmë të votojmë



Pa demokraci, ne s'do të ishim qytetarë kaq aktiv

DEMOKRACIA NDËR VITE

LEON (11), ERONA (10), ENESI (11), ALISA (11), AULONI (11), ELVIRA (10)

ME JEMI



Në artikullin më poshtë do të mund të lexoni më shumë për demokracinë dhe për elementet e saj

Të kesh të drejtën e fjalës së lirë do të thotë shumë. Me anë të shprehjes së mendimit, ne mund të bëjmë ndryshime të mëdha duke filluar prej vendit tonë. Popujt ndër vite kanë luftuar dhe kanë sakrifikuar shumë që sot t'i gëzojmë këto të drejta, të gjithë qytetarët e planetit tonë. Prandaj, është përgjegjësia jonë që të punojmë dhe ta ruajmë atë që është shumë e vlefshme e që na ka ofruar shumë, e që ajo është demokracia. Demokracia është formë e qeverisjes, ku qytetarët janë të lirë të flasin për atë çka mendojnë. Ata e kanë të drejtën për t'i zgjedhur përfaqësuesit e tyre me anë të votave. Të mirat e demokracisë janë të shumta, por ato që e bëjnë demokracinë të kompletuar janë elementet e saj. Toleranca si element i rëndësishëm i demokracisë duhet të jetë e pranishme në çdo shtet, ashtu siç ndodh në Kosovë, ku kemi tolerancë ndër-etnike dhe nuk bëjmë diskriminime. Me qytetarët që u takojnë komuniteteve jo shumicë ne sillemi mirë, sepse ne së bashku i ndajmë shkollat dhe të gjitha institucionet e tjera. Elementet e tjera të demokracisë janë, duke filluar me barazinë ku të gjithë jemi të barabartë para ligjit. Më pas, solidariteti që ka të bëjë me ofrimin e ndihmës tek personat në nevojë. Si dhe është respekti. Atë ne sot e kemi bërë gjatë gjithë kohës sa shoqet dhe shokët e tjerë kanë qenë duke folur, sepse i kemi dëgjuar ata dhe ato.

Shteti ynë ka demokraci përfaqësuese me sistem parlamentar, ku qytetarët i zgjedhin deputetët përmes të cilëve i shprehin shqetësimet dhe kërkesat e tyre. Duke iu falenderuar diskutimit të sotëm rreth demokracisë, ne e kuptuam rëndësinë e saj dhe të mirat që ua sjell demokracia shteteve të gjithë botës.




Sepse është më e mira



Së bashku drejt së ardhmes

KUVENDI, SHTËPIA E LIGJEVE

BLENDINA (10), YLLI (11), DRIN (10), DION (10), ELIANA (10), LEORENT (11)



Struktura dhe funksionet bazë të Kuvendit të Kosovës rrjedhin nga Kushtetuta

Funksionet e Kuvendit të Kosovës kanë ndikim shumë të madh në jetën tonë

Të dashur lexues në artikullin tonë, do të informoheni më shumë rreth punës të cilën e bën një institucion shumë i dashur dhe që luan një rol shumë të rëndësishëm në jetën tonë. Ky institucion është Kuvendi.

Ne, nxënës të klasës së V-të, sot e kuptuam më shumë rolin e këtij institucioni dhe të gjitha ato që i mësuam do t'i transmetojmë tek ju.

Kuvendi, është institucioni i cili e rregullon funksionimin e një shteti, si dhe punon që qytetarët e Republikës së Kosovës të kenë një jetë sa më të mirë. Për këtë punojnë të zgjedhurit e popullit, të cilët ne i njohim si deputetë. Gjithsej në Kuvend kuvendojnë 120 deputetë, ku 100 prej tyre janë të kombit shqiptar, ndërsa 20 të tjerë janë prej komuniteteve jo shumicë që janë: serbë, boshnjakë, turq, romë, ashkalinjë, goranë dhe egjiptianë.

Ajo çka duhet të theksohet është se të gjithë këta deputetë janë të barabartë edhe pse iu përkasin etnive të ndryshme. Përveç që iu përkasin etnive të ndryshme këta deputetë po ashtu janë të partive të ndryshme. Me një fjalë, të gjithë janë qytetarë të Republikës së Kosovës.

Ashtu siç e cekëm më lart, funksionet e Kuvendit kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën tonë. Por, cilat janë ato funksione mund të pyet dikush? Funksionet e Kuvendit të Kosovës janë: funksioni përfaqësues, funk-

sioni i kontrollit si dhe funksioni legjislativ. Të gjitha këto funksione kanë ndikim shumë të madh tek ne. Funksioni legjislativ ka rëndësi shumë të madhe sepse këtu miratohen ligje, që ne si qytetarë duhet t'i përmbahemi dhe t'i respektojmë. Po ashtu, ka ligje të cilat na prekin direkt neve si nxënës. Për shembull, nëse një shkolle i mungojnë nxemjet qëndrore, atëherë kjo çështje duhet të adresohet. E kjo do të na ndihmonte që të kemi një mjedis më të mirë në shkollë. Gjithashtu, edhe funksioni përfaqësues ka rol të rëndësishëm tek qytetarët. Kështu të dashur lexues, besojmë që sado pak t'iu kemi dhënë informata të mjaftueshme për Kuvendin dhe rëndësinë e tij.



Puna brenda grupit të vogël, e cila është bërë me shumë përkushtim dhe dashuri, për ju të dashur lexues



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë:
Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560
E-mail: info@demos-ti.org
Website: www.demos-ti.org

Pjesëmarrësit:

SHFMU „Dëshmorët e Kombit“
Klasa: V-3
Vendi: Kamenicë